



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

SEKTORI JURIDIK

Nr. 1414/prot.

Tiranë, më 10/11/2021

URDHËR

NR. 160, Datë 9/11/2021

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS SË PRANIMIT DHE SHQYRTIMIT TË DOKUMENTACIONIT, NGA ANA E FAKULTETEVE TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE, PËR STUDENTËT, TË CILËT DO TË APLIKOJNË PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE, PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË”, PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022 NË UART

Në zbatim të nenit 112 të ligjit Nr.80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” të neneve 1 dhe 5 të ligjit Nr 10289, datë 17.06.2010 për “Mënyrën e trajtimit ekonomik dhe financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”; të nenit 2 të ligjit Nr. 7889 datë 14.12.1994 për “Statusin e invalidëve të punës”(i ndryshuar), VKM Nr.869, datë 18.06.2008 “Për zbatimin e ligjit Nr.7889 datë 14.12.1994 për Statusin e invalidëve të punës” i ndryshuar; nenit 6 të ligjit Nr.8153, datë 31.10.1996 për “Statusin e jetimit (i ndryshuar)” nenit 8 të ligjit Nr.8098 datë 28.03.1996 për “Statusin e të verbërit (i ndryshuar)”; nenit 8 të ligjit Nr.8626 datë 22.06.2000 për “Statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar); nenit 12 të ligjit Nr.7748, datë 29.07.1993 për “Statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist” (i ndryshuar);nenit 32 të ligjit Nr.9355 datë 10.03 2005 për “Ndhmën dhe shërbimet shoqërore” (i ndryshuar), të VKM Nr.903, datë 21.12.2016 për “Përcaktimin e kriteve për përfitimin e bursave nga fondit i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” (i ndryshuar), të VKM Nr.39, datë 23.01.2019 “Për disa ndryshime në VKM Nr.903 datë 21.12.2016”;

URDHËROJ

1. Ngritjen e grupit të punës në fakultetet e Universitetit të Arteve për pranimin dhe shqyrtimin e aplikimeve të studentëve që do të përfitojnë bursë për vitin akademik 2021-2022



2. Punonjësit që do të merren me administrimin e procesit në çdo fakultet, do të jenë si më poshtë:

- Nermin Zebi (Fakulteti i Muzikës)
- Arta Dashi (Fakulteti i Arteve të Bukura)
- Enela Mastori (Fakulteti i Artit Skenik)

3. Grupi i punës në Fakultete ka për detyrë të pranojë dhe shqyrtojë dokumentacionin sipas kriterëve të përcaktuara në VKM Nr. 903, datë 21.12.2016 për “Përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” (i ndryshuar).

4. Afati përfundimtar për dorëzimin e dokumentacionit, nga studentët është data 25.11.2021.

5. Grupi i punës mban proces verbalin ku përcaktohen studentët që përfitojnë ose jo bursë për vitin akademik 2021-2022 dhe e përcjell për verifikim dokumentacionin pranë Sektorit Juridik.

6. Afati përfundimtar për mbarimin e punës nga ana e grupit të punës është data 30.11.2021.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri grupi i punës, Dekanët, Sekretarët në Fakultete, Zyra e protokollit pranë Universitetit të Arteve dhe sektori i IT.

8. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

Prof. Kastriot ÇAUSHI

**REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE**

